

**GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Dalip Bega kryetar, Mejreme Zekaj dhe Ramiz Kuqi anëtarë, me pjesëmarrjen e sek. juridike Zymrije Çunaku, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga i pandehuri Idriz Muzaqi nga Vushtrria, kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Vushtrri, Nr.I.regj.6569/11, datë 05.03.2012, në bazë të nenit 39,219 dhe 222 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 27.03.2012 merr

### AKTVENDIM

Ankesa e paraqitur është e **BAZUAR**.

**ABROGOHET** aktvendimi i atakuar dhe lënda i ~~ktehet gjykatës së shkallës së parë në~~ rishqyrtim dhe rivendosje.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	<b>DPK / DMP</b>
Nr. l faq. Broj stranica Nr. pages	<b>02</b>
Nr. Prot. Er Prot Prot No	<b>03-1344/2012</b>
Data Datumi Date	<b>12.04.2012</b>

### Arsyetim

**Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Vushtrri**, sipas aktvendimit Nr.I.regj.6569/11, të datës 05.03.2012, të pandehurin Idriz Muzaqi nga Vushtrria, e ka shpallur përgjegjës sepse i pandehuri si zyrtarë i lartë i Komunës së Vushtrrisë, ka qenë i obliguar që deri më 31 mars 2011 ta bëjë deklarin e pasurisë së vet dhe ta njoftoi agjencinë kundër korrupsionit në Prishtinë, mirëpo këtë nuk e ka bërë deri në afatin e cekur më lartë, me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 16 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit për deklarin prejardhjen dhe kontrollimin e pasurisë dhe dhuratave të zyrtarëve të lartë publik e pasurisë rendin dhe qetësinë publike, dhe i ka shqiptuar dënimin me gjobë në shumë prej 300 (njëqind).-€, duke e obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej 5 (pesë).- €.

Kundër këtij aktvendimi i pandehuri ka paraqitur ankesë në të cilën përpos tjerash thekson se me aktvendimin e atakuar Gjykata Komunale për Kundërvajtje ka bërë shkelje të dispozitave materiale të Ligjit për deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave nga se ka bërë vërtetim të gabuar të gjendjes faktike. Më tutje thekson se sipas ligjit është e paraparë që deklarin e pasurisë duhet ta bëjë, pos të tjerëve, edhe drejtori i administratës dhe personelit, kështu që ky si i pandehur gabimisht është futur në listë si i obliguar për deklarin në fjalë. Këtë e dokumenton me faktin se ky nuk kryen detyrën e drejtorit në Drejtorin për Administratë dhe Personel, por vetëm detyrën e drejtorit të drejtorisë për administratë deri sa Drejtor i Drejtorisë për Personel është dikush tjetër dhe për të gjitha këto afron dëshmi të ndryshme në formën e shënimeve zyrtare të Komunës së Vushtrrisë etj. andaj propozon që aktvendimi i atakuar të anulohet dhe ky si i pandehur të lirohet nga përgjegjësia.

Kolegji vlerësoi thëniet në ankesën e paraqitur, aktvendimin e atakuar, deklarin e të pandehurit të dhënë në seancën e shqyrtimit pranë gjykatës së shkallës së parë më datë 14.11.2011 në të cilën mohon të ketë kryer kundërvajtjen e cila i ngarkohet me arsyetim se nuk ka pasur obligim të deklarimit të pasurisë bazuar në pozitën e tij në Kuvendin Komunal, por duke u bazuar edhe në shkresat tjera të lëndës, andaj ankesën e paraqitur nga i pandehuri e aprovoi si të bazuar, ndërkaq aktvendimin e atakuar e abrogoi dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

2.

Kolegji vendosi për abrogimin e aktvendimit të atakuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kundërvajtëse dhe mos vërtetimit të plotë të gjendjes faktike.

Dispozitivi i aktvendimit të atakuar është i pakuptueshëm dhe në kundërtënie me vetveten në pjesën që ka të bëjë me emërtimin e ligjit në bazë të të cilit i shqiptohet gjoba sepse pos ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave të zyrtarëve të lartë publik, vazhdohet edhe: rendin dhe qetësinë publike, sikurse edhe në pjesën e cila përcakton shqiptimin e dënimit me gjobë, sepse nuk mund të kuptohet se të pandehurit i është shqiptuar gjoba në shumë prej 300.-€-siç është theksuar me shifër, apo i është shqiptuar gjoba prej (njëqind).-€- siç është theksuar me fjalë. Njëherit nga deklarata e të pandehurit të dhënë në gjykatë rezulton se i njëjti e mohon kundërvajtjen gjegjësisht e ka mohuar obligimin për deklarim të pasurisë duke ofruar dëshmitë sipas të cilave ai mendon se e lirojnë nga kjo përgjegjësi, deri sa gjykata nuk ka nxjerr asnjë provë tjetër për ta dëshmuar dhe për ta bindur të pandehurin për obligimin apo mos obligimin e tij, lëshime këto të cilat e bëjnë të paqëndrueshëm aktvendimin mbi dënimin.


Në plotësim procedure gjykata e shkallës së parë duhet të veproj sipas vërejtjeve të theksuara më lartë, të ftoj dhe të merr në pyetje ushtruesin e kërkesës i cili do të deklarohet rreth pretendimeve të të pandehurit bazuar edhe në pozitën e tij si zyrtarë i lartë publik për çka e ngarkon kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse, të administroj edhe prova tjera eventuale dhe më në fund varësisht nga vërtetimi i gjendjes faktike të merr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në Ligj.

Më sa u tha më lartë konform nenit 222 të Ligjit mbi Kundërvajtjet u vendos si në dispozitiv. Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

**GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË.**

**GJL.nr.364/2012, datë 27.03.2012.**

**SEK. JURIDIKE,**  
**Zymrije Çunaku**



**KRYETARI I KOLEGJIT.**

**Dalip Bega**

